



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranë / Prilburo Me Data 30.09.2024			
Organi Broj	Numri Broj	Subjekt Pranë	Vlera Vrednost
01	110	05	1154



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.09.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për transferin (rialokimin) e mjeteve buxhetore në mes programeve, nëprogrameve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për transferin (rialokimin), rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore, granti qeveritar, fondi burimor - 10 dhe të hyrat vetanake, fondi burimor - 21, kategoria ekonomike investime kapitale në mes programeve - nëprogrameve buxhetore në shumë prej 63,073.76 € e nga fondet burimore të projekteve si vijon :

Fondi burimor 10

Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinohen mjetet mes projekteve (shuma 10.000.00 €)

Programi buxhet e financa (175), nënprogrami buxhetimi (17533)

Nga projekti:

Ndërtimi i urave (Jezava, Gelbushi, Podgorc – Lubishtë, Budrikë dhe Skifteraj) kod i projektit 55027 në shumë prej 10.000.00 €.

Në projektin:

Participimi i projekteve me donator, kod i projektit 90552 në shumë prej 10.000.00 €.

Fondi burimor 21

Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinohen mjetet mes projekteve (shuma 53.073.76 €)

Programi buxhet e financa (175), nënprogrami buxhetimi (17533)

Nga projekti: Ndërtimi i urave (Jezava, Gelbushi, Podgorc - Lubishtë, Budrikë dhe Skifteraj) kod i projektit 55027 në shumë prej 53,073.76 €.

Në projektin : Participimi i projekteve me donator kod i projektit 90552 në shumë prej 53.073.76 €

Koment: Bartja e mjeteve prej projektit, Ndërtimi i urave (Jezava, Gelbushi, Podgorc-Lubishtë Budrikë dhe Skifteraj) është kërkuar për arsye se ky projekt edhe pse ka qenë në proces të tenderimit, por vazhdimisht nuk ka pasur operator serioz gjatë ofrimit për të bërë të mundur lidhjen e kontratës për kryerjen e punëve.

Neni 2

Pas lejitimit të ridestinimit të mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi nga Ministria për Financa, Punë dhe Transfere, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

